



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:246683  
Datë: 31.03.2022  
Numri i dokumentit: 02865933

**C.nr.1015/2021**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË DEGA MALISHEVË, Departamenti Përgjithshëm, Divizioni Civil**, gjyqtari Nehat Qelaj, me bashkëpunëtorin profesional Visar Morina, në kontestin e paditësit K. për D. dhe F. me E.E.Sh.a. (K.) me seli në P. Rr “B.B. K. nr.... N. e E., kati ... nr... P.( tutje paditësja), kundër T. M.M. nga fsh. B. (J.) K-M. (tutje e paditura), për shkak të kompensimit të dëmit material, vlera e kontestit 141.33 €, me datën 31.03.2022, jashtë shqyrtimit mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**LËSHOHET URDHËRPAGESA** për paditësen K.për D.dhe F. me E. E. Sh.a. (K.) me seli në P.Rr “Bulevardi B. K. nr.... N. e E., kati ... nr... P. dhe **DETYROHET** e paditura T. M. M. nga fsh. B. (J.) K-M., që në emër të kompensimit të dëmit material, t’ia paguaj paditësit shumën në lartësi prej 141.33 euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit duke filluar nga nxjerrja e këtij Aktvendimi datë: 31.03.2022 e deri në përmbushjen definitive të detyrimit, si dhe shpenzimet e dhënies së urdhërpagesës, në shumë prej 20 euro të gjitha këto në afatin prej 7 ditëve, nën kërcenim të përmbarimit me dhunë, apo që brenda afatit të njëjtë të parashtrorj prapësimin kundër kësaj urdhërpagese.

**A r s y e t i m**

Paditësja në këtë gjykatë ka parashtruar padi, kundër të paditurit, për shkak të kompensimit të dëmit material, vlera e kontestit 141.33 Euro.

Paditësja padisë ia ka bashkangjitur edhe Aktgjykimin Gjykatës Themelore në Gjakovë dega Malishevë, me numër P.nr.31/2019, të dt.05.02.2021, dhe faturën e kalkulimit me numër ... e dt.28.08.18 dhe faturën e llogaritjes së dëmit D. dt.29.08.2018.

Duke marrë parasysh aktgjykimin Gjykatës Themelore në Gjakovë dega Malishevë, me numër P.nr.31/2019, të dt.05.02.2021 i plotfuqishëm nga dt.28.04.2021, dhe faturën e kalkulimit me numër ... e dt.28.08.18 dhe faturën e llogaritjes së dëmit D... dt.29.08.2018, konstatohet se e paditura ka detyrim ndaj paditësit që të paguaj shumën prej 141.33 euro në emër të shkakimit të dëmit material me veprën penale për çka edhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendim për lëshimin e urdhërpagesës.

Nga sa u tha më lartë, e duke u bazuar në nenin 493.3 dhe 495, e në lidhje me nenin 497.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2021:246683  
Datë: 31.03.2022  
Numri i dokumentit: 02865933

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË DEGA MALISHEVË**  
**Departamenti Përgjithshëm, Divizioni Civil**  
**C.nr.1015/2021, me datë 31.03.2022**

**Gjyqtari**  
**Nehat Qelaj**

**KËSHILLË JURIDIKE:** I padituri mund ta goditë urdhërpagesën vetëm me anë të prapësimit dhe atë brenda afatit 7 ditor pas ditës së pranimit të së njëjtës. Prapësimi i paraqitur me vonesë do të hidhet poshtë.